

VENDIM
Nr.1031, datë 8.10.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS DISHNICË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.529, datë 1.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Dishnicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dishnicë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
2-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
12-14	Monumente historike, buste me interes vendor&prona social-kulturore e sportive	Në pronësi
15-18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
19-32	Shërbime funerale	Në pronësi
33-43	Infrastrukturë (rugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
87-89,91-93,95-96,98-100,102-103,105-106,108-110,112,114-115,117-119,121-123,125-126,128-129,131-132,134-136	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore).	Në përdorim
90,94,97,101,104,107,111,113,116,120,124,127,130,133,137	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë jobujqësore).	Në pronësi
140-141,147-148,151,153,158,159 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren në fushën e kullimit dhe ujitjes	Në pronësi

179-182	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi
---------	--	------------